

RELACION ARKITEKTONIK

“Studim projektim për Mirëmbajtjen e Thellë të Hidroizolimit të tarracave në objektet publike”,
BASHKIA TIRANË

Informacione te përgjithshme.

Gjendja ekzistuese e objekteve

Objektet e marra në studim projektim janë tre shkolla 9 vjecare ne Bashkinë Tiranë. Këto objekte kanë probleme me lagështine qe vjen nga tarracat. Në te gjithë objektet problem i vazhdueshëm është lagështia nga soletat e cila është prezente në tavanet e klasave dhe korridoreve duke u bërë shqetësuese. Nga inspektimet ne terren dhe verejtja ne vend e situates shihet qe kjo lagështi vjen nga soletat, të cilat nuk kanë hidroizolim,e kane te 'demtuar ose kanë hidroizolim te pjesshëm . Lagështia sjell edhe renien e suvase se tavaneve dhe mureve , duke krijuar nje ambient aspak te sigurt per zhvillimin e mesimit dhe sigurine e jetes se femijeve.

Foto me poshte tregojne gjëndjen egzistuese te taraces se objekteve :

Dhe perkatesisht si me poshte :

1. Shkolla "Kongresi i Lushnjes"

Shkolla "Kongresi i Lushnjes" ndodhet në Njësinë Administrative Nr. 3, në Rr. "Qemal Stafa". Është godinë 3 katëshe me sip të përgjithshme 1523m² dhe sipërfaqe ndërtimi 1423. Në këtë objekt zhvillojnë procesin mësimor 654 nxënës.






2. Shkolla "Kongresi i Manastirit"

Shkolla "Kongresi i Manastirit" ndodhet në Njësinë Administrative Nr.6 në rrugën "3 Dëshmorët". Është një godinë 4 katëshe me sipërfaqe të përgjithshme 3560m² dhe me sipërfaqe ndërtimi 1345m². Në këtë objekt zhvillojnë procesin mësimor 1540 nxënës.

Foto nga gjëndjia egzistuese :





3. Shkolla "Ahmet Gashi"

Shkolla "Ahmet Gashi" ndodhet në Njësinë Administrative Nr. 11 në Rrugen "Pandi Dardha".






Propozimi per mirëmbajtjen e thellë të objekteve.

Duke pasur parasysh gjendjen ekzistuese të të tre objekteve më sipër , u vu re se problematikat vijnë nga mungesa e standarteve, amortizimi dhe mungesa e hidroizolimit . Në vecanti , te shkolla "Ahmet Gashi" problematika shtohet edhe nga shkarkimet vertikale të ujrave të shiut , pasi duke qenë të brendëshme , kanë difekte izolimi dhe montimi dhe për pasojë krijojnë lagështi edhe në ambjentet e brendëshme. Në këtë rast ato do të ndryshojnë vedin dhe do të jenë të jashtëme, në mënyrë që të mund të kontrollohen më mirë dhe të mirëmbahen më kollaj.

Prandaj , duke qenë edhe objekte të një rëndesie të vecantë , ne si projektues propozojmë prishjen e shtresave ekzistuese dhe ribërje edhe njëherë të shtresave të taracave që janë sipas standarteve të projektimit dhe përkatësisht sipas detajeve me poshtë:


1. DETAJE TE SHTRESAVE, PARAPETEVE KULLIMIT TE UJRA



Rekomandohet që ndërtuesi dhe mirëmbajtësi të përmbahen specifikimeve teknike dhe të kryejnë punimeve sipas detajeve dhe standarteve teknike.

Realizimi i projektit Kaloi fazat dhe u mbështet në VKM.Nr. 354 , Datë 11.05.2016.

Kosto totale e projekteve është përcaktuar në preventivin përfundimtar të objektit , i cili është bazuar në projekt dhe specifikimet teknike dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standartet e kërkuara. Për çdo ndryshim në detaje , në shtresa apo specifika të veçanta , zbatuesi duhet të konsultohet me projektuesin dhe të marrë miratimin e tij për ndryshimin e projektit.



Detaj i hidroizolimit, termoizolimit, shtresat në taraca